



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK

UDHËZIM NR. 4

PËR AFATET E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË CERTIFIKIMIT

Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 525, datë 13.05.2009, “Për miratimin e Rregullores për Nënshkrimin Elektronik”, Kreu II, pika 2/b, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik,

UDHËZON:

Të gjithë personat fizik dhe juridik që duan të ushtrojnë aktivitetin shërbimit të certifikimit elektronik ose të organizmit të testimit dhe konfirmimit, duhet t’i përmbahen afateve të poshtëshënuara:

1. Mbështetur në **Nenin 11, të Ligjit dhe Kreun II, pika 2 të Rregullores**, Autoriteti brenda 5 ditëve (ose më shumë kur e gjykon të arsyeshme) pas dorëzimit të aplikimit nga Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit (OSHC), konfirmon që aplikimi përmban të gjitha dokumentet e nevojshme dhe për ato që mungojnë njofton subjektin përkatës për plotësimin e tyre brenda 20 ditëve. Nëse dokumentacioni i munguar nuk plotësohet në afatin e kërkuar, atëherë kërkesa e subjektit rrezohet. Autoriteti vendos për regjistrimin e aplikuesit brenda 20 ditësh nga data e dorëzimit të dokumentacionit. Një ofrues

shërbimi i regjistruar është i detyruar të dorëzojë pranë një Organizmi Testimi dhe Konfirmimi (OTK) dhe Autoritetit, çdo ndryshim të bërë në raportin që specifikohet sipas nenit 23 të ligjit. OTK kontrollon këto modifikime, kryen vlerësimet dhe konfirmon pajtueshmërinë ligjore dhe teknike, brenda një periudhe kohore prej 20 ditësh dhe ia dorëzon raportin Autoritetit.

2. Mbështetur në **Nenin 39, pika 1, të Ligjit**, OSHC-të mbajnë një kopje në formë shkresore ose elektronike dhe krijojnë Arkivin e Certifikatave të Kualifikuara, i cili duhet të ruhet nga lëshuesit për 20 vjet që nga data e revokimit ose mbarimit të vlefshmërisë. Ky arkiv përdoret në të gjitha rastet kur nevojitet verifikimi i dokumentacionit të plotë të certifikatave të kualifikuara.
3. Mbështetur në **Nenin 40 të Ligjit**, zotëruesi i kodeve të nënshkrimit, kërkon të njihet me të dhënat dhe hapat procedurale të lidhura me to, të cilat ruhen nga Ofruesi i Shërbimit. OSHC është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 15 ditësh, që nga momenti i dorëzimit të kërkesës.
4. Mbështetur në **Nenin 46 të Ligjit**, kur Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit ndërpret aktivitetin, duhet të lajmëroje Autoritetin dhe klientët 3 muaj para, ose në pamundësi raporton menjëherë me ndërprerjen e aktivitetit. Ai duhet të jetë në gjendje të provoje se i ka njoftuar ose nuk ka qenë në gjendje t'i njoftojë në kohën që parashikohet në këtë pike.
5. Mbështetur në **Nenin 46, Pika 2/b, të Ligjit**, kur certifikatat e vlefshme kalojnë nën kontrollin e një ofruesi tjetër të shërbimeve, brenda 15 ditëve duhet të njoftohet me shkrim Autoriteti.

6. Mbështetur në **Kreun III/3 të Rregullores**, Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit që fillon aktivitetin duhet të dëshmojë se plotëson kërkesat e cituara në këtë pikë si dhe rinovon këto dokumente çdo 1 vit. Në raport pasqyrohet hollësisht gjendja financiare për 3 muajt e fundit.

7. Mbështetur në **Kreun III pika 5/f të Rregullores**, OSHC-të, janë të detyruar të njoftojnë Autoritetin për çdo ndryshim në detajet/specifikimet e tyre përfshirë këtu edhe regjistrin, brenda një afati prej 15 ditësh që nga momenti i ndryshimit.

8. Mbështetur në **Kreun IV/8 të Rregullores**, një subjekt që kërkon të njihet si Organizëm Testimi, duhet të dorëzojë një aplikim në Autoritet, me të cilin do kërkojë njohjen e tij dhe në të njëjtën kohë duke dorëzuar gjithë dokumentacionin e listuar në Rregulloren për Nënshkrimin Elektronik.
Autoriteti brenda 10 ditësh punë (ose me shumë kur e gjykon të arsyeshme) nga data e dorëzimit të aplikimit, verifikon dokumentacionin e depozituar dhe në rast se konstaton mangësi, brenda 15 ditësh njofton kërkuesin për plotësimin e tyre. Aplikimi hidhet poshtë nëse nuk dorëzohen brenda këtij afati. OTK duhet të njoftojë Autoritetin për ndërprerjen e aktivitetit të tij të paktën 5 muaj përpara se kjo të ndodhë ose në pamundësi të njoftojë menjëherë në momentin e ndërprerjes së veprimtarisë së tij.
Aktiviteti OTK duhet të rivlerësohet të paktën një herë çdo 3 vjet.

9. Mbështetur në **Kreun IV, pika 8/f të Rregullores**, konfliktet që mund të lindin midis Ofruesit të Shërbimit të Certifikimit dhe Organizmit të Testimit, zgjidhen me ndërhyrjen e Autoritetit ose/ dhe në rrugë gjyqësore. Palët në konflikt, paraqesin ankimin pranë Autoritetit, i cili brenda 15 ditëve (ose me shumë kur e gjykon të arsyeshme), dëgjon pretendimet e palëve dhe merr vendim për zgjidhjen e konfliktit. Nëse palët nuk bien dakord me vendimin e Autoritetit, ato mund të bëjnë ankim në gjykatë për zgjidhjen e çështjes brenda 30 ditësh nga shpallja e vendimit të Autoritetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

20/07/2009

DREJTORI

Sadi HOTI